

MEMO: Njohja e shoqërive tregtare në marrëdhëniet me Serbinë

Më 31 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim me nisë zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet me Serbinë.¹ Qeveria planifikon që përfundimisht të ketë reciprocitet të plotë me Serbinë në të gjitha fushat. Vendimi i 31 marsit gjithashtu parasheh rishikimin e masave të reciprocitetit dhe mundësinë e zgjerimit të tyre.²

Një nga masat e reja të reciprocitetit mund të përfshijnë njohjen e personalitetit juridik të shoqërive tregtare. Ky memo është diskutim fillestar i bazës faktike dhe ligjore për këtë masë.

Faktet

Qeveria ka prova se autoritetet në Serbi nuk njohin shoqëritë tregtare të regjistruara në Kosovë.³ Duke vlerësuar çështjen e një biznesi kosovar, në dhjetor 2015, i ashtuquajtur Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës i Republikës së Serbisë thotë:

Biznesi i synuar nuk është i regjistruar në ARB në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare të RS (Gazeta Zyr. RS nr. 36/2011, 99/2011, 83/2014 dhe 5/2015). Biznesi i synuar është regjistruar në Prishtinë, si shoqëria “Exclusive Pharma” SH.P.K. Regjistrimi i pretenduar nuk është kryer në përputhje me ligjin e RS, as nga autoritetet e RS, andaj Komisioni konsideron se [regjistrimi] nuk mund të prodhojë efekt juridik.⁴

Autoriteti serb nuk ka njohur personalitetin juridik të shoqërisë së regjistruar në Kosovë:

Më tej, rrjedh se subjektiviteti i këtij pjesëmarrësi në treg nuk mund të pranohet, të cilin vetë parashtruesi e pranon, duke paraqitur një njoftim për një përqendrim të cilin ai thotë se ka të bëjë

1 Vendim i Qeverisë 01/20, 31.3.2020.

2 Po aty, pika 3.

3 Rešenje [Vendim] br. 6/0-02-901/2015-9, Komisija za zaštitu konkurencije (Republika Srbija), 29.12.2015, kzk.gov.rs/odluke/feniks-farma-dooel-bjr-makedonija-gaz.

4 Po aty, f. 3 («Циљно пословање није регистровано у АПР-у у складу са Законом о привредним друштвима РС (Сл. гласник РС бр. 36/2011, 99/2011, 83/2014 и 5/2015). Циљно пословање је регистровано у Приштини, као друштво Exclusive Pharma SH.P.K. Наводна регистрација није извршена у складу са правом РС, нити од стране органа власти РС, из ког разлога Комисија сматра да иста не може да производи правно дејство.»).

me kontrollin mbi biznesin e synuar (dhe jo për fitimin e kontrollit mbi kompaninë).⁵

Autoriteti serb ka barazu biznesin kosovar me pronarin «një person fizik, zoti Gazmend Abrashi, shtetas i Serbisë».⁶ Njëherësh, ka konsideru se zoti Abrashi ushtron veprimtari në Serbi, sepse «Krahina e Kosovës dhe Metohisë» është pjesë e Serbisë.⁷

Komisioni në Beograd ka shpërfillë edhe Marrëveshjen e Brukselit që përmend shoqëritë e themeluara sipas së drejtës së Kosovës:

Në marrjen e këtij pozicioni, Komisioni kishte parasysh pretendimet e mëposhtme në kërkesën për përjashtime në përputhje me të a.q. Marrëveshje e Brukselit. Edhe pse a.q. Marrëveshje e Brukselit aktualisht merret vetëm me çështje të kufizuara, siç janë telekomunikacioni, energjia, drejtësia, etj., dhe përmend në fakt ekzistencën e kompanive «të krijuara në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullatore të Kosovës», të cilat nuk kanë personalitet juridik të njohur në përputhje me ligjin e RS. Si shembull, raporti thotë se Telekom Srbija, në përputhje me marrëveshjen e Qeverisë së RS, tashmë ka regjistru një filial në agjencinë e Kosovës, dhe është rënë dakord që NP Elektrokosmet të krijojë kompaninë e vet dhe ta regjistrojë atë në agjencinë e Kosovës.⁸

Ligji

Për të zbatu reciprocitetin në njohjen e shoqërive tregtare, Republika e Kosovës do mund të vendoste një rregull me këtë efekt:

-
- 5 Po aty («Из тога даље произлази да се не може прихватити субјективитет овог учесника на тржишту, што и сам подносилац пријаве прихвата, подносећи пријаву концентрације за коју наводи да се ради о стицању контроле над циљним пословањем (а не о стицању контроле над привредним друштвом).»).
- 6 Po aty («физичко лице, господин Абраши Газменд, држављанин Србије»).
- 7 Po aty, f. 4 («Покрајина Косово и Метохија»; citon nenin 182 të Kusht. Serbisë).
- 8 Po aty («Код заузимања оваквог става, Комисија је имала у виду и следеће наводе у пријави о изузецима у складу са тзв. Бриселским споразумом. Иако се тзв. Бриселски споразум тренутно бави само ограниченим питањима као што су телекомуникације, енергетика, правосуђе итд., на више места се помиње фактичко постојање предузећа која су „основана у складу са косовским правним и регулаторним оквиром,“ а која немају признати правни субјективитет у складу са правом РС. Као пример, у пријави је наведено да је Телеком Србија, сходно договору Владе РС, већ регистровао зависно друштво при косовској агенцији, а договорено је и да ЈП Електрокосмет оснује своје друштво и исто региструје код косовске агенције.»).

Pa marrë parasysh formën e organizimit të saj në Serbi, një shoqëri tregtare nga Serbia është, në përputhje me Ligjin 06/L-016 për shoqëritë tregtare të Republikës së Kosovës:

- (1) biznes individual i personit fizik që kontrollon shoqërinë;
- (2) ortakëri e përgjithshme e personave fizikë që kontrollojnë shoqërinë.

Por duhet pasë parasysh këto shqetësime, që kërkojnë hulumtim të mëtejshëm:

- *Fuqia prapavepruese* — Masa mund të mos zbatohet prapaveprimisht. Ndonëse institucionet tona mund të refuzojnë personalitetin juridik të shoqërive nga Serbia, do të ishte juridikisht dhe praktikisht e vështirë, në mos e pamundshme, me i zhbë veprimet e mëparshme. Në veçanti, masa do të nxirrte telashe për Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës, e cila përdor sisteme të automatizuara dhe ligjërisht dhe ka kapacitet të kufizuar për t'i vërtetu të dhënat.
- *Mospërputhja me ligjin* — Ligji për shoqëritë tregtare njeh parimisht personalitetin juridik të shoqërive të regjistruara sipas ligjeve të një shteti të huaj. Madje ua mundëson regjistrimin e bizneseve dhe degëve në Kosovë. Një mënyrë me kapërcy këtë pengesë është me argumentu se Kosova nuk njeh Serbinë si shtet.
- *Mospërputhje me Marrëveshjen e Brukselit* — Masa mund të bide ndesh me detyrimet nga dialogu në Bruksel lidhur me kompanitë serbe që do të regjistrohen në Kosovë. Megjithatë, masa mund të ngushtohet që me leju detyrimet e Brukselit.
- *Identifikimi i kontrollit* — Me personin fizik që kontrollon shoqërinë nënkuptojmë praktikisht pronarin. Kur ka një pronar, shoqëria do llogaritej biznes individual; kur ka dy pronarë, do quhej ortakëri e përgjithshme e pronarëve. Por zbatimi i kësaj mase ndërlikohet kur pronari është person juridik dhe nuk zbulohet se kush ushtron kontrollin përfundimtar.